PROCESVERBALI I MBLEDHJES DATE 29.08.2025

Sot ne sallen e mbledhjeve te KB Devoll zhvillohet mbledhja e rradhes e cila u zhvillua diten e sotme date 29.08.2025 pasi diten e djeshme date 28.08.2025 mbledhja u anullua per shkak te mos plotesimit te kuorumit.Te pranishem ne salle : Alfredi Gjata,Ilir Hoxha ,Valbona Spaho ,Imelda Cucka ,Kledi Cenkolli,Festim Kaso ,Oliver Mulla ,Trifon Meraku ,Genti Demcolli, Vladimir Gjyli ,Vladimir Kello ,Albana Skoti.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 1. Miratimi i rendit te dites.

Hapet votimi:

12 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 2.

Miratimi i procesverbalit te mbledhjes date 29.07.2025

Hapet votimi:

12 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Pyet keshilltaret nese kane konflikt interesi me PV per kete muaj. Keshilltaret pohuan se nuk kane asnje konflikt interesi .Vazhdomje me piken 3. PV Nr 49 date 21.08.2025 " Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri ne 6% per bllok-ndihmen ekonomike per muajin Korrik 2025."
Keshilltari Trifon Meraku ka nje paqartesi ne lidhje me listen e ndihmes se bashkise per nje grua pesjoniste e cila mungon kete muaj.

Sqarohet nga specialisti i zyres duket i dhene pergjigjet e kerkuara .

Hapet votimi 12 pro 0 kunder 0 abstenim

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 4 . Projekt-Vendim Nr.50 Datë 21.08.2025 " Për disa ndryshime në të ardhurat per taksën e ndikimit në infrastrukture dhe tarifen per qera trualli."

Vladimir Gjyli: Planifikimi i te ardhurave ne infrastrukture per 2025 ishte 1 milion e 300 mije behet 4 milion , pse?

Gazmend Malo: Ky eshte nje ze i cili nuk mund te parashikohet asnjehere fiks per arsye se keto jane te gjitha ndertimet e reja. Kjo eshte taksa per ndertimet e reja per lejat e ndertimit. Ne kemi pasur disa leja te dhena jashte parashikimeve te urbanistikes.

Vladimir Gjyli: Taksa e lejes te ndertmit do te jete sic ka qene apo do ndryshoje?

Gazmend Malo: Asgje nuk do te ndryshoje , jane te ardhura te paparashikuara qe jane arketuar kete vit , tarifa eshte e pandryshuar .

Hapet votimi 12 pro 0 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 5 Projekt-Vendim Nr.51 Datë 21.08.2025 "Miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave te perbashketa midis njesive te veteqeverisjes vendore dhe keshillit te ministrave te Republikes se Shqiperisë per rritjen e kapaciteteve të geverisjes vendore, Akademia e trajnimit të njesive të vetëqeverisjes vendore te Republikës së Shqiperisë."

Enkelejda Collaku: Eshte nje lloj akademie qe do krijohet per te permiresuar performancen e punonjesve . Ka te beje me trajnime per punonjesit e bashkise , per te gjitha strukturat.

Vladimir kello: ku do te ngrihet kjo TALGA ?

Enkelejda Collaku: Funksionon njelloj si shoqeri tregetare, regjistrohet ne gjykate . Kjo eshte e ndare me qarqe.

Vladimir Kello: Kjo me duket nje hallke e tepert per sa i perket pushtetit vendor .

Enkelejda Collaku: Cdo njeri evolon ,te gjithe kemi nevoje per trajnime , cdo kush ka nevoje te permiresohet.

Festim Kaso: Sa eshte kostoja financiare per Bashkine?

Enkelejda Collaku: 300 mij lek per vitin e pare dhe vitet ne vijim e me pas ndryshon ,

Genti Demcolli: Per trajnime cdo kush ka nevoje . Se sa i rendon buxhetit te Bashkise eshte per tu diskutuar.

Ilir Hoxha : sa efektive do te kete.

Enkelejda Collaku: Ky eshte nje miratim ne parim me pas do te behet dhe marreveshja me kryetarin.

Hapet votimi 11 pro 1 kunder 0 abstenim.

Alfredi Gjata : Vazhdojme me PV Nr 52 datë 26.08.2025 "Per miratimin e perfituesve nga programi suvbvencioni i interesave te kredise per strehim" i cili erdhi mbasi ishte mbyllur rendi i dites.

Nuk ka diskutime per kte PV.

Hapet votimi 12 pro 0 kunder 0 abstenim.

Genti Demcolli: Nuk eshte problemi tek PV te cilat vijne te gatshme edhe pse shum kane qelluar qe nuk na pelqen, ne pergjithesi jane miratuar, problemi eshte tek mungesa e drejtuesve Bashkiake. As Kryetari dhe asnje nenkryetar prezent tregon per ne se konsiderohemi "krere" si ato dhente. Une kam nje pyetje por ne mungese te ketyre qe sapo permenda ose sekretarja e keshillit te therres dike nga urbanistika per sinjalistiken e qytetit, ne lidhje konkretisht me tabelat e vendosura tek rruga e Bashkise .

Me sa di une vendime te caktuara jane ndryar dhe korigjuar brenda nates ne varesi te tekave te personave te caktuar qe kane influence mbi kryetarin e mbi te tjere . Tabelat dhe rregullimi i sinjalistikes ne qytet supozohet te kete nje urbanist te specializuar, te kete specialist te fushes perkatese , te konsultohet me publikun dhe a mund te anashkalohet Keshilli Bashkiak per vendime te tilla?

Alfredi Gjata: Sugjeroj te besh nje kerkese me shkrim qe ne ta futim ne rendin e dites .

Genti Demcolli : Kryetar , jane disa probleme qe nuk presin muaj pasi ne mblidhemi nje here ne muaj . Ky mund te jete i madh per dike i vogel per dike tjt .

Keta zotrinjte qe jane ulur ketu i eshte dashur te miratojne projektvendime edhe ne momentin e fundit sepse u digjej dhe skishin me kohe . Une denjova te vij sot edhe shum mir mos te vija sipas standartit qe eshte krijuar ketu, nje here ne 6 muaj e kemi te drejten , por un denjova te vij per te plotesuar kuorumin qe splotesohet nga ata qe vijne nje here ne 6 muaj.

Genti Dmecolli: Probleme pafund ka dhe qyteti qe hoqen stolat dhe kane len 50 cop mermera dhe nuk po i vendosin . Kur? Kur do ulen, Dimrit? Etj etj problematika . Ku u desh vendimi i te madhit fare qe te vinte te hiqte arkat qe shisnin ne shkallet e Bashkise apo ne mes te sheshit?

Genti Demcolli: Vendos kryetari nje tabel te madhe atje ne shtylle dhe e sjell si risi te madhe ne qytet dhe s'mendon qe nje lagje e tere sic eshte " Grucka" dhe rruga e spitalit nuk perballojne aq trafik pasi dhe punonjesit e Bashkise parkojne para istitucioneve te Bashkise, gati sa nuk i futin brenda. Zgjidhja me e mire eshte te ndalohet parkimi.
Po te jete nevoja do ti qartesoj dhe me shkrim problematikat e mia , nqs eshte kjo menyra qe merren parasysh .
Trifon Meraku: Une personalisht kam patur konflik edhe me policine bashkiake dhe qarkullimin dhe pa nje sqarim direkt mbushin gjoben duke i ndare njerzit. Mire eshte qe ne si Keshill Bashkiak te na merret mendimi sepse kjo nuk eshte personale por ka te beje gjithe qyteti. Ose te pakten te behet me orar zyrtar 8-4.
Nje problem tjeter me kendin e lojerave te femijeve. E kam ngritur shume here si shqetesim por me sa shoh nuk eshte marre parasysh. Aty kane ngelur vetem disa zinxhire, une per fatin e mire kam dy femije dhe dal perdit, po te shohesh gjendjen e parkut eshte skandaloze. Mund edhe te punesohet nje punonjese nga Bashkia te rrije aty si kujdestare per mirembajtjen e kendit. Cdo dite zihen femijet. Neper pedonale ka dhe shume qen.
Oliver Mulla: Para disa ditesh nje kamion me targat e Librazhdit leshoi qen endacake ne nje lagje te qytetit tone. Mendoj qe kamerat e sigurise te qytetit te shqyrtohen dhe dergohen tek organet kompetente per te marre masa ne menyre parandalimi dhe zgjidhje te ketyre problemeve.
Alfredi Gjata: Mendoj qe keto gjera ti diskutojme perseri ne prani te kryetarit qe te gjejme nje zgjidhje sa me te mire.

Mbledhja deklarohet e mbyllur!

Protokolluesi :
Kostandina Brakolli

Alfredi Gjata